



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

VITI YNË NË MOMENTE KRYESORE

Reporti vjetor 2021

Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!



**“Le të përmirësojmë bujqësinë sot,
për një të nesërme më të mirë”.**

Të nderuar lexues,

Unë, në emër të IADK-së, dëshiroj të falënderoj sinqerisht të gjithë që me durim e vazhduan këtë rrugëtim me ne. Rrugëtimi i zhvillimit të bujqësisë sigurisht që ka vështirësitë e veta; megjithatë frytet që korrim e bëjnë atë një proces të këndshëm.

Viti i lënë pas dhe pandemia e vazhdueshme na ka bërë të vlerësojmë fuqishëm secilin, puna e të cilëve ka qenë thelbësore për të na mbajtur të sigurt, të ushqyer dhe të shëndetshëm. Edhe një herë, secili i përfshirë në bujqësi dhe gamën e gjerë të aktiviteteve të saj (aktivitete të kryera nga ferma deri te konsumatori) kanë dëshmuar se është një nga profesionet më thelbësore në botë.

Falë partneritetit të jashtëzakonshëm të donatorëve, partnerëve, fermerëve/përfituesve, ekipit të IADK-së dhe palëve të interesuara, ne kemi arritur të vazhdojmë punën e mirë në sektorë të ndryshëm të bujqësisë. Këtë vit, përpjekjet tona janë fokusuar në rritjen e punësimit në bujqësi dhe krijimin e të ardhurave, fuqizimin dhe mbështetjen e grave në krijimin e bizneseve të tyre, krijimin e mundësive për zhvillim profesional dhe punësim përmes ofrimit të trajnimeve për fermerët dhe praktikave për të sapo diplomuarit, mbështetjes së përfituesve në disa nga bjeshkët më të largëta për të kryer aktivitete turistike dhe shumë të tjera. Për më tepër, përpjekjet tona për krijimin e një Qendre të Arsimit dhe Aftësisë Profesionale kanë qenë të suksesshme. Kandidatët e interesuar në sektorin e përpunimit të qumështit apo frutave dhe perimeve, kanë mundësinë të ndjekin trajnimin në Njësitë e Përpunimit të Ushqimit dhe të pajisen me një certifikatë të njohur në nivel kombëtar të validuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).

Ju lutemi, vazhdoni të lexoni këtë raport vjetor, në mënyrë që të mësoni më shumë për arritjet tona më të mëdha, rezultatet nga projekte dhe shërbime të ndryshme dhe të shihni ndikimin tonë në sektorë të ndryshëm të bujqësisë në Kosovë.

Sinqerisht i juaji,
Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv i IADK-së



Përmbajtja

Rreth IADK

Fushëveprimi Ynë

Puna Jonë e Ilustruar

Donatorët, Projektet dhe Shërbimet e IADK-së në vitin 2021

17 SGD-të dhe Kontributi Ynë

Sektori i Perimeve

Sektori i Pemëtarisë

Sektori i Blegtorisë

Sektori i Bletarisë

Sektori i Përpunimit të Ushqimit

Sektori i Bimëve Mjekësore dhe Aromatike

Sektori i Agroturizmit

Arsimi dhe Aftësimi Profesional (AAP)

Punësimi dhe Praktika

Partneritete Ndërkombëtare

Rreth IADK

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2005.

IADK kontribuon në zhvillimin e:
Prodhimtarisë Primare, Blegtorisë,
Përpunimit të Ushqimit dhe zhvillimit të
Turizmit malor dhe Agroturizmit në zonat
rurale të Kosovës.



MISIONI

Misioni ynë është të promovojmë zhvillimin socio-ekonomik të zonave rurale, të reduktojmë papunësinë dhe të krijojmë mundësi për gjenerimin e të ardhurave për njerëzit që jetojnë në zonat rurale.


VIZIONI

Vizioni ynë është zhvillimi i bujqësisë moderne për jetesë rurale, zhvillim gjithëpërfshirës dhe mjedis të qëndrueshëm në Kosovë.

Fushëveprimi Ynë

Në vitin 2021, IADK ka punuar në 18 komuna (në disa me dy projekte ose më shumë) në Republikën e Kosovës:

- | | | |
|-------------|---------------|---------------|
| 1. Drenas | 7. Malisheva | 13. Shtërpçë |
| 2. Ferizaj | 8. Mitrovicë | 14. Shtime |
| 3. Gjilan | 9. Novobërdë | 15. Skenderaj |
| 4. Istog | 10. Pejë | 16. Viti |
| 5. Kamenicë | 11. Podujevë | 17. Vushtrri |
| 6. Lipjan | 12. Prishtinë | 18. Zveçan |



Për ta përmbledhur, IADK në 2021 kishte:



198 Përfitues



875,157 Të ardhurat vjetore



7 Projekte/Grante & **7** Projekte/Shërbime



28 Punonjës dhe **12** Praktikantë dhe vullnetarë




8 Donatorë




12 Partner

Puna Jonë e Ilustruar



4%

Pjesa e bujqësisë
në BPV globale



7.4%

Pjesa e bujqësisë
në BPV e Kosovës



198
Përfitues



76%

Burra

Nga totali i
përfituesve, 76%
ose 152 përfitues
janë burra



24%

Gra

Nga totali i
përfituesve, 24%
ose 46 përfituese
janë gra



16

Biznese të reja
janë
themeluar



182

Mundësi të
vetëpunësimit



8

Biznese të
drejtuara
nga Gratë




50

Sisteme solare
të montuara në
bjeshkë



22

Përmirësime të
infrastrukturës
në bjeshkë




59

Serra janë
montuar



35

Tharëse
natyrale janë
ndërtuar



2

Tharëse dyshemeje
për BMA



67

Kultivator u
shpërndanë



37

Fermer janë
mbështetur në
sektorin e
BMA-ve



35

Fermer janë
mbështetur në
sektorin e
blegtorisë



8

Bletar janë
mbështetur me
pajisje për
bletari



1

Fermer është
mbështetur në
sektorin e shpeztarisë



7

Fermer janë
mbështetur në
sektorin e pemëtarisë



1

Kultivues i luleve
është mbështetur


Puna Jonë e Ilustruar

Të rinjtë (18-35) të mbështetur me grante



153

Kandidatë u certifikuan pas përfundimit të trajnimeve të AAP-së



49

Trajnime teknike në bujqësi



634

Këshilla direkte në terren



48

Burra



20

Vizita studimore në fermat model



53

Studentë të angazhuar në praktikë në punë



20

Trajnime të mbajtura me student



19

Gra

Gjenerimi i të ardhurave



151 Përfitues

0 - 1,000€



15 Përfitues

1,001 - 1,200€



15 Përfitues

1,201 - 1,600€



75 Përfitues

> 1,600€



2

Raporte



7

Broshura



2

Fletëpalosje

Shënim: Kjo përfaqëson të ardhurat e krijuara nga përfituesit e vitit 2020, të cilët ne i monitoruam dhe i këshilluam vazhdimisht, dhe ata të vitit 2021.



Konferenca e dytë kombëtare e organizuar me temë:
"Sfidat dhe mundësitë e prodhimtarisë organike dhe eksportit të BMA-ve"

Donatorët, Projektet dhe Shërbimet



Brot
für die Welt

Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës

Projekti fokusohet në trajnime profesionale dhe grante për fermer të vegjël, gra dhe të rinjtë



Fuqizimi i të rinjve dhe grave nga zonat rurale përmes përfshirjes në bujqësi dhe përpunim të ushqimit

Projekti fokusohet në fuqizimin e grave dhe të rinjve në sektorin e përpunimit të ushqimit




giz

Mbështetja e zinxhirit të vlerave të BMA përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimit të eksportit

Projekti fokusohet në mbështetjen e prodhimit organik të BMA-ve dhe promovimin e eksportit




DRC DANISH
REFUGEE
COUNCIL

Mbështetja e Ndërmarrësisë Shoqërore dhe Promovimi i Fuqizimit Social-Ekonomik të Komuniteteve Minoritare në Kosovë

Projekti fokusohet në sektorë të ndryshëm të bujqësisë me theks në mbështetjen e minoriteteve



e IADK-së gjatë vitit 2021



Krijimi i vendeve të punës në bujqësi

.....

Projekti u fokusua në rritjen e kapacitetit prodhues të BMA-ve në mënyrë organike



Mbështetja në punësimin e të rinjve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë

.....

Projekti i fokusuar në mbështetjen e nisjes së bizneseve të reja dhe të vetëpunësimit në sektorin e bujqësisë



Transhumanca - ofertë e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi

.....

Projekti i fokusuar në përmirësimin e agroturizmit, në bjeshkët e Istogut dhe Pejës



Shërbime profesionale të ofruara

.....

Kemi kryer hulumtime, kemi ofruar shërbime këshillimore teknike, trajnime profesionale dhe konsulencë për partnerë si: FAO, HBF, SDC, SIRED, SOWI, PPSE, EPI CENTAR



17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs), të njohura edhe si Objektivat Globale, u miratuan nga Kombet e Bashkuara në 2015 si një thirrje universale për veprim për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur planetin dhe për të siguruar që deri në vitin 2030 të gjithë njerëzit të gëzojnë paqe dhe prosperitet.

17 SDG-të janë të integruara, ato pranojnë se veprimi në një fushë do të ndikojë në rezultatet në të tjerat dhe se zhvillimi duhet të balancojë qëndrueshmërinë sociale, ekonomike dhe mjedisore.



Kontributi ynë për SDG-të

IADK përmes projekteve të saj të shumta ka realizuar aktivitete që synojnë të kontribuojnë në Objektivat Globale të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Nga 17 SGD, IADK në përpjekje për të nisur ndryshim, ka ndërmarrë aktivitete që kontribuojnë në 10 prej këtyre.



IADK përmes projekteve të saj synon të mbështes grupet më të cënueshme, fermerët e zonave të largëta, në mënyrë që të rrisë burimet dhe shërbimet bazë dhe të krijojë mundësi për gjenerimin e të ardhurave.



Janë zbatuar disa aktivitete që synojnë të rrisin produktivitetin bujqësor dhe të ardhurat e prodhuesve të ushqimit në shkallë të vogël, në veçanti të grave dhe fermerëve familjarë, përmes qasjes të sigurt dhe të barabartë në tokë, njohuri dhe mundësi punësimi.



Shumica e fermerëve tanë janë të vetëdijshëm dhe të trajnuar siç duhet për praktikën më të mira bujqësore dhe parandalimin e ndotjes së ujit dhe tokës.



Të gjitha projektet tona kanë komponentin e rritjes së kapaciteteve profesionale të fermerëve përmes trajnimeve, këshillave direkte, vizitave studimore e të tjera. Gjithashtu, ne kemi realizuar aktivitete që përfshijnë ofrimin e aftësimin profesional ku pjesëmarrësit morën certifikatë të njohur në nivel kombëtar.



Fuqizimi i grave është prioritet për ne. Janë zbatuar disa aktivitete që nxisin fundin e diskriminimit, dhunës dhe grave u është dhënë qasje në pronësinë e granteve në formën e të mirave materiale. Për më tepër, ata janë mbështetur në procesin e hapjes së bizneseve të tyre.



Fermerët tanë janë tashmë plotësisht të vetëdijshëm dhe të zellshëm në reduktimin e ndotjes nga aktivitetet e tyre bujqësore dhe të përdorin me përgjegjësi ujin. IADK punon ngushtë me fermerët dhe i këshillon ata për trajtimin e duhur të kimikateve në mënyrë që të përmirësohet cilësia e ujit.



Në përpjekje për të siguruar çasje universale në shërbime energjetike të përballueshme, të besueshme dhe moderne, IADK përmes projekteve të saj ka mbështetur fermerët në male me sisteme diellore si pjesë e një projekti agroturistik. Tani, kushtet e tyre të jetesës dhe shërbimet e tyre turistike janë përmirësuar.



Duke marrë një qasje gjithëpërfshirëse, ne kemi zbatuar shumë aktivitete që mbështesin krijimin e vendeve të denja të punës, ndërmarrësi dhe fermat e vogla dhe të mesme.



Praktikat e duhura bujqësore dhe konsumi i përgjegjshëm i burimeve promovohen shumë përmes trajnimeve tona. Bazuar në monitorimin tonë, fermerët në zonat ku ne kemi zhvilluar aktivitetet tona kanë filluar të menaxhojnë më mirë mbetjet e fermave dhe përdorimin e kimikateve.



IADK bashkëpunon me shumë institucione qeveritare, organizata partnere, shoqata të fermerëve, shoqata të grave, si dhe institucione e organizata ndërkombëtare me qëllim të shkëmbimit të njohurive, ekspertizës dhe burimeve, për të mbështetur arritjen e synimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë.

Sektori i Perimeve

Sipas Raportit të Gjelbër 2021, të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në Kosovë gjatë vitit 2020 janë kultivuar 19,243 ha perime.

Këto sipërfaqe kultivohen në fushë të hapur, në serra dhe kopshte. Prodhimi i perimeve për vitin 2020 vlerësohet në 290.555 ton, krahasuar me një vit më parë ka një rënie të prodhimit për 3.3%.

Këto ndryshime në produktivitet kanë ardhur si rezultat i ndryshimeve në kushtet klimatike së fundmi dhe pandemisë së vazhdueshme COVID-19.

Në përpjekje për të rritur prodhimin e perimeve dhe për të krijuar mundësi për gjenerimin e të ardhurave të familjeve rurale, IADK përmes projekteve të saj të shumta ka mbajtur trajnime, ka mbështetur fermerët me grante në të mira, këshilla direkte, dhe shumë shërbime të tjera.

62

Përfitues



76

Këshilla direkte



7

Sesione të trajnimeve teknike



Sektori i Perimeve

"Për herë të parë kam mundur të siguroj të ardhura për familjen/fëmijët e mi".

Lumturije Hyseni nga fshati Sllavi, komuna e Lipjanit, përfituese e serrës me pajisje përcjellëse. Duke punuar në serrë, ajo ka arritur të gjenerojë të ardhura duke shitur produkte dhe të përmirësojë mirëqenien e familjes së saj.

6 UJË I PASTËR
DHE KANALIZIME



Sektori i Pemëtarisë

Pemëtaritë vazhdojnë të jenë një sektor shumë premtues me kushtet të përshtatshme agro-ekologjike dhe pedologjike të Kosovës. Konsiderohet si e tillë pasi gjeneron një numër të madh punëtorësh, veçanërisht të rinj, falë punës së palodhur të fermerëve arrin të sigurojë rendimente të kënaqshme dhe cilësi shumë të lartë. Sipas Raportit të Gjelbër 2021 sipërfaqja me pemishte në vendin tonë për vitin 2020 shënon 10,265 ha, krahasuar me vitin 2019 sipërfaqet me pemishte janë rritur me rreth 780 ha ose 8%. Trendi i rritjes së sipërfaqeve me pemishte ndikon në uljen e importeve dhe rritjen e prodhimit vendas të pemëtarisë. Nëse i referohemi prodhimit nga pemishtet, në Raportin e Gjelbër 2021 thuhet se prodhimi është rritur gjatë vitit 2020 me 7% krahasuar me vitin 2019 dhe përbën një total prej 72,265 tonësh.

IADK edhe këtë vit ka vazhduar përkrahjen e fermerëve me grante dhe trajnime në këtë sektor duke rritur njohuritë e fermerëve. IADK, krahas aktiviteteve tjera, ka organizuar trajnime praktike me fermerët për krasitjen, ujitjen dhe plehërimin, si dhe mirëmbajtjen e plantacioneve të frutave. IADK ka mbajtur trajnime për menaxhimin e ujitjes dhe plehërimit në pemishte në mënyrë që fermerët të kenë rendimente të cilësisë së lartë si dhe të mbrojnë rezervat ujore dhe tokën nga kontaminimi dhe prishja e strukturës.

7

Përfitues



18

Këshilla direkte



7

Sesione të
trajnimeve teknike

Sektori i Pemëtarisë

"Tani, dredhëzat tona
vërtet shijojnë aq mirë sa
duken"

Sabit Ademi nga fshati Vinarc, Komuna e Mitrovicës është përfitues i fidanëve të dredhëzave, folies dhe plehrave, sistemit të ujitjes, dhe vazhdimisht është këshilluar për kultivimin e tyre. Ai ka arritur të sigurojë rendiment dhe cilësi të lartë nga fidanët e fituar dhe është i njohur në rrethinën e Mitrovicës për cilësinë e dredhëzave të tij. Në vitin e parë të prodhimit, ai ka realizuar një fitim prej 500 €.

2 ZERO
URI



Sektori Blegtorisë

Sipas Raportit të Gjellbër 2021, gjedhët janë kategoria më e rëndësishme brenda blegtorisë dhe përbëjnë 47.5% të totalit të krerëve të bagëtive.

Cilësia dhe sasia e prodhimit të qumështit dhe mishit varet (ndër faktorëve të tjerë) nga higjiena e fermës, përzgjedhja e ushqimit dhe përgatitja e racionit të balancuar për bagëtinë.

Pajisjet dhe trajnimet e duhura janë jetike për rritjen e cilësisë dhe sasisë së mishit, qumështit dhe shëndetin e duhur të bagëtive. Fermerët mbështeten vazhdimisht nga IADK përmes trajnimeve të aftësimiit profesional në blegtori, granteve në të mira dhe shërbimeve këshillimore për sektorin e blegtorisë.

36

Përfitues

31 prej tyre burra



Sesione të aftësimiit profesional në sektorin e blegtorisë

138

Mbështetur me pajisje bujqësore sipas nevojave të tyre



5 prej tyre gra

29

Këshilla direkte të dhëna nga stafi profesional i IADK-së

Sektori Blegtorisë

"Pajisjet më ndihmuan
në rritjen e
produktivitetit në
fermën time për 30%"

Bekim Gajtani është përfitues nga fshati Ruboc, komuna e Kamenicës. Ai ka marrë një mikser ushqimi për përgatitjen e ushqimit të koncentruar dhe është trajnuar për zgjedhjen e ushqimit cilësor dhe përgatitjen e një racioni të balancuar. I lumtur, ai rrëfeu rritjen e sasisë së qumështit të prodhuar dhe të ardhurat më të larta të krijuara nga ferma e tij. Ai është mbështetur në shtator 2021 dhe deri në fund të vitit ka gjeneruar të ardhura prej 1,500 €.

12 KONSUM DHE
PRODHIM
I PËRGJEGJSHËM



Sektori i Bletarisë

Sipas Raportit të Gjellbër 2021, në vitin 2020 numri i koshereve është rritur me 19,4% krahasuar me një vit më parë. Prodhimi i mjaltit në vitin 2020 ishte shumë më i ulët se në vitin 2019, si pasojë e kushteve jo të favorshme atmosferike që ishin në vitin 2020, të cilat ndikuan në prodhim.

Në vitin 2020 janë importuar 253 ton mjaltë, që krahasuar me vitin 2019, sasia e importuar ka qenë 10% më e lartë, ndërsa eksporti i mjaltit ka qenë vetëm 75 kg dhe kjo sasi është eksportuar në Republikën Çeke. Duke marrë parasysh prodhimin vendor dhe sasinë e importuar, në Kosovë në vitin 2020 janë konsumuar 1,040 ton mjaltë, pra një banor i Kosovës ka konsumuar 0.6 kg gjatë vitit. Mbulimi i nevojave të konsumit nga prodhimi vendas ishte 76%.

Si përpjekje për të reduktuar importin e mjaltit, IADK përmes projekteve të saj ka mbështetur sektorin e bletarisë me grante në të mira materiale, trajnime dhe këshilla direkte.



Sektori i Bletarisë

"Familja ime mori rrugën
më të ëmbël drejt suksesit;
tani ne fitojmë para nga
mjalta!"

Safet Peci është përfitues nga fshati Zhazhë, komuna e Zveçanit. Ai është mbështetur me bletë dhe pajisje adekuate që e ndihmojnë që nga mbarështimi i bletëve deri në vjeljen e produktit. Falë mbështetjes me pajisjet thelbësore, Safeti ka arritur të rrisë efikasitetin dhe të arrijë rezultate më të mira, duke siguruar rendiment më të lartë dhe cilësi më të mirë të mjaltit.

1 PA
VARFËRI



Sektori Përpunimit të Ushqimit

Puna e papaguar e kryer nga gratë në mbarë botën, punët e shtëpisë dhe të kujdesit të papaguar (ndaj fëmijëve dhe pleqëve), llogaritet të paktën dy herë e gjysmë më shumë sesa puna e burrave.

Sipas raporteve të OKB-së, kujdesi i papaguar dhe puna shtëpiake vlerësohet të jetë 10 dhe 39% e BPV-së dhe mund të kontribuojë më shumë në ekonomi sesa sektorët e prodhimit, tregtisë ose transportit.

Për të krijuar vende pune më të paguara për gratë dhe për të përshpejtuar progresin në fuqizimin ekonomik të grave, IADK i ka fokusuar aktivitetet e projektit në ndërmarrjet e grave. Gratë janë trajnuar se si të bëjnë konservimin e frutave dhe perimeve, si të përpunojnë e ruajnë qumështin dhe nënprodukteve të tij, dhe si të bëjnë prodhimin e ëmbëlsirave. Për më tepër, shumë prej tyre janë mbështetur me grante për të hapur bizneset e tyre.

Përmes ofrimit të pajisjeve moderne përpunuese, IADK ka mbështetur hapjen e bizneseve të udhëhequra nga gratë:


**2 për
përpunimin
e frutave &
perimeve**



**5 për
përgatitjen e
ëmbëlsirave**



**1 për
prodhimin e
produkteve
të qumështit**



Sektori Përpunimit të Ushqimit

"Më në fund, ëndrra ime u bë realitet. Unë kam biznesin tim dhe jam e zoja e vetës."

Alba Zejnullahu është përfituese nga fshati Ramjan, komuna e Vitisë. Ajo ka mbajtur trajnimin për ëmbëlsira dhe i është dhënë një grant (pajisje) për krijimin e biznesit të saj "Alba Cakes". Ajo fitoi pavarësinë e saj financiare duke zotëruar biznesin e saj dhe punëson gra të tjera me të njëjtat synime.



Njësitë e Përpunimit të Ushqimit

Në Kosovë ka një boshllëk të qartë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP) në sektorin e përpunimit të ushqimit, veçanërisht për përpunimin e frutave/perimeve dhe qumështit. IADK në përpjekje për të adresuar këtë çështje, përmes projektit të saj dhe donatorit Bread for the World ka themeluar Njësitë e Përpunimit të Ushqimit (NPU) në Sfaracak të Ulët, Vushtrri. Gjithashtu, IADK si institucion ka pasuruar programet e saj të trajnimit profesional duke futur dy programe në Përpunimin e Ushqimit:

- **"Qumështar" dhe**
- **"Konservues i frutave, perimeve dhe të ngjashme".**

Këto programe janë të vlefshme dhe të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit (AKK) i nivelit III sipas Kualifikimit të Kornizës Kombëtare dhe të licencuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Programet e modulit janë krijuar për të qenë 70% mësim praktik, Njësitë e Përpunimit të Ushqimit (NPU) do të shërbejnë për të përgatitur punonjësit e ardhshëm të përpunuesve të ushqimit dhe NVM-të. Koncepti i të mësuarit bazohet në mësimdhënien praktike, ku kandidatët do të mësojnë 70% përmes ushtrimeve praktike. Pas përfundimit të trajnimit, kandidatët do të pajisen me një certifikatë të njohur ndërkombëtarisht dhe do të posedojnë aftësitë për të qenë përpunues profesional ushqimor të fituara në IADK.



Nga AAP në Përpunues

“Mbështetja me trajnime profesionale në sektorin e qumështit dhe pajisjet më kanë mundësuar të krijoj biznesin tim”

Bedrije Buja është trajnuar në sektorin e qumështit dhe përkushtimi dhe munda e saj u shpërblye nga IADK. Ajo u bë përfituese e pajisjeve për përpunimin e qumështit dhe aktivitetet e saj i kryen në fshatin e saj Bujan - Komuna e Lipjanit.

Përmes trajnimeve, ajo arriti të përmirësojë cilësinë dhe sigurinë e produkteve të saj, përmes njohurive dhe pajisjeve të fituara filloi të shes dhe plasoj produktet e saj në tregun vendor, të shpërndara nga biznesi i saj "Qumështorja Buja".

4 ARSIM
CILËSOR




IADK Raporti Vjetor | 2021



Sektori Bimëve Mjekësore dhe Aromatike

Në Kosovë, një sektor që po shënon rritje të vazhdueshme është bujqësia organike, veçanërisht sektori i bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA). Sipas Raportit të Gjelbër 2021, të dhënat për vitin 2020 tregojnë se janë gjithsej 1,672 ha sipërfaqe me prodhimtari organike, ku bimët mjekësore dhe aromatike janë 1,039.71 ha. Ky sektor mbetet shumë fitimprurës dhe eksporti i bimëve mjekësore dhe aromatike tregon rritje të vazhdueshme në vlerë, i cili arriti vlerën më të lartë të eksportit në vitin 2020 që ishte 8.9 milionë €.

Duke parë potencialin e lartë të sektorit, IADK përmes projekteve të saj ka mbështetur studentët, të sapodiplomuarit dhe fermerët me trajnime, praktikë dhe grante në të mira për të kontribuar më tej në zhvillimin e sektorit. Studentët dhe të sapodiplomuarit janë trajnuar, dhe arsimi dhe aftësitë e tyre janë përputhur me kërkesat e kompanive përkatëse në sektorin e BMA-ve. Ndërsa, fermerët janë trajnuar dhe këshilluar për kultivimin e BMA-ve dhe janë mbështetur me grante në të mira si: fidane, sistem ujitjes, tharëse natyrale dhe pajisje shoqëruese.




20

Motokultivator



35

Tharëse natyrale
janë montuar



2

Tharëse dyshemeje
për BMA



20

Fermer janë
mbështetur me
sistem të ujitjes



20

Fermer janë
mbështetur me
fidane të BMA-ve

Sektori i BMA -ve

"Tani, BMA-t tona janë organike dhe fitimi i parasë vjen organikisht për familjen time"

Mustaf Gjyheri nga fshati Ruhot, Komuna e Pejës, vjen nga komuniteti ashkali dhe përkrahja e grantit për kultivimin e bimëve mjekësore ishte shumë e rëndësishme për të dhe familjen e tij. Përveç marrjes së fidanëve, sistemit të ujitjes, tharëses natyrale dhe mekanizmit bujqësor, përmes projektit ai ka marrë edhe trajnime bazë për teknikat e kultivimit të BMA-ve dhe menaxhimin e fermës, si dhe këshilla të drejtpërdrejta gjatë kultivimit të këtyre bimëve. Gjatë aktivitetit të tij ekonomik në sektorin e BMA-ve, Mustafa ka realizuar të ardhura prej 1,920 € për vitin 2021.

3 SHËNDET I MIRË
DHE MIRËQENIE



Sektori i Agroturizmit

Sektori i Udhëtimit dhe Turizmit, pavarësisht kufizimeve të vazhdueshme të lëvizshmërisë, ka kontribuar 5.5% në BPV-në globale, me 272 milionë të punësuar në të gjithë sektorin në nivel global (WTTC, 2021). Sektori ka parë një rritje në ardhjet ndërkombëtare të turistëve (vizitorë që qëndrojnë gjatë natës) u rrit me 58% në korrik-shtator 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 (OBT, 2021).

Ky trend vërehet edhe në Kosovë, ku një rritje e turizmit vendor dhe atij ndërkombëtar është evidentuar në krahasim me vitin 2020. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Statistikat e Hoteleve, TM3 2021, numri i vizitorëve vendor ishte 47,720, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ku vlera ishte 18,985. Ndërkohë, në TM3 2021 numri i vizitorëve ndërkombëtarë është 80,786 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ku vlera ishte 21,286.

Statistikat e përmendura nuk arrijnë të kapin numrin e plotë të vizitorëve që mund të qëndrojnë në stanet tradicionale ose të bëjnë kampe në natyrën e pacënuar të bjeshkëve tona. Vendet e Ballkanit janë të njohura për praktikimin e një tradite, e cila duket se ka humbur prej kohësh për vendet e zhvilluara. Kjo traditë është migrimi sezonal i bagëtive përgjatë rrugëve migratore në bjeshkë të njohura si Transhumancë. Vendasit në Kosovë jo vetëm që janë të dashur, por janë të etur për të ruajtur traditat e tyre. Pas një analize të kujdesshme, shfrytëzimi i kësaj tradite si një atraksion turistik konsiderohet si një mundësi për të krijuar jo vetëm një ofertë turistike të veçantë por edhe tërheqëse për turistët.

Duke bashkëpunuar ngushtë me familjet stanare, ne kemi arritur të kuptojmë disa nga sfidat dhe boshllëqet e tyre kryesore në zhvillimin e agroturizmit. Mungesa e energjisë elektrike dhe kapaciteti për të akomoduar turistët janë padyshim më kryesoret. IADK përmes projektit të saj ka adresuar këto çështje, duke ofruar mbështetje me anë të sistemet solare për 50 stanarë; ndërsa mungesa e kapaciteteve është adresuar duke siguruar 10 kasolle të barinjëve për përfituesit.



50 stane janë mbështetur me sisteme solare



IADK ka ndërtuar 10 kasolle barinjsh



IADK ka ndërtuar 8 pika pushuese



IADK ka ngritur 4 kampe



Përfituesit janë trajnuar për ofrimin e shërbimeve turistike



Sektori i Agroturizmit

“Çdo natë, sa herë që i dhezim dritat, gruaja ime thotë: "Shnet ju boft atyne që na sollën dritat!"

Agush Rexhaj është përfitues i sistemit solar nga komuna e Pejës. Ai praktikon transhumancën, merr bagëtinë e tij në bjeshkën e Sejnovës, ku ai dhe familja e tij ofrojnë shërbime turistike për turistët kalimtarë. Burimi i pastër i energjisë ka qenë një ndryshim i jetës për familjen e tij dhe cilësinë e shërbimeve që ato ofrojnë.




7 ENERGJI
E PËRBALLUESHME
DHE E PASTËR




Arsimi dhe Aftësimi Profesional

Në total, janë mbajtur 140 seanca trajnimesh profesionale.




174 pjesëmarrës kanë qenë pjesë e trajnimeve profesionale




Nga 174 certifikata të lëshuara, 153 ishin të validuara nga AKK



Nga 174 kandidatë, 110 kanë qenë gra ose 63.2%



Nga 174 kandidatë, 64 kanë qenë burra ose 36.8%




Numri i sesioneve trajnuese të mbajtura në sektorë të ndryshëm

IADK është në proces të pasurimit të programeve të saj të AAP-së për të përfshirë sektorin e ëmbëlsirave, BMA-të dhe produktet pyjore jo-drusore (PPJD).



Vizita studimore

Për të gjeneruar një shkëmbim përvojash dhe praktikash të mira ndërmjet fermerëve dhe fermave model, pemishteve dhe njësive apo fabrikave të përpunimit të ushqimit, IADK organizon vizita të ndryshme studimore. Këto vizita studimore organizohen për sektorë të ndryshëm si përpunimi i ushqimit, sektori i fruta-perimeve, blegtoria, bletaria dhe sektori BMA-ve. Bazuar në reagimet e pjesëmarrësve, këto vizita kanë qenë një mundësi mësimi për pjesëmarrësit dhe kanë frymëzuar ndryshime pozitive për fermat e tyre ose NVM-të.



**"Nëse ata e bonën prej zeros, pse nuk mundemi na?"
- Një nga pjesëmarrësit**





Punësimi dhe Praktika

IADK synon të përmirësojë cilësinë e jetës dhe mirëqenien ekonomike të njerëzve që jetojnë në zonat rurale, dhe me rritjen e kërkesës globale për ushqim, sektori i bujqësisë ofron mundësi të pashfrytëzuara punësimi.

Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore 2020, nga 38.3% e popullsisë që është ekonomikisht aktive, 25.9% janë të papunë. Shkalla e papunësisë së të rinjve të moshës 15-24 vjeç, këtë vit është mjaft e lartë, kjo vlerë është 49.1%. Kur flasim për përqindjen e pjesëmarrjes së të rinjve të moshës 15-24 vjeç, të cilët nuk janë as të punësuar, nuk ndjekin trajnime apo arsimim është mjaft e lartë dhe ka pasur një rritje të vazhdueshme në këto vite, dhe në vitin 2020 ishte 33,6%.

Potenciali i pa-shfrytëzuar i sektorit dhe papunësia e lartë, janë trajtuar nga IADK përmes disa projekteve. Ofrimi i praktikave është përdorur si katalizator i punësimit të të rinjve në sektorin e bujqësisë. Përderisa ata janë përgatitur para praktikave me trajnime për aftësitë e buta të cilat janë jetike për mundësitë e ardhshme të punësimit.



Punësimi dhe Praktika

“Nëse të punosh shumë dhe të përkushtohesh konsiderohet me fat, atëherë kam pasur fatin të kaloj nga një praktikante në një punëtore”

Gresa Kurti është e sapodiplomuar në Teknologji dhe Inxhinieri Ushqimore nga Mitrovica. Ajo ka qenë e etur për të mësuar gjatë pesë (5) ditëve të trajnimit të aftësive të buta, më pas ka qenë aktive si praktikante për tre muaj në Drejtorinë e Inspektimit. Rrjedhimisht, motivimi i saj i lartë u vu re dhe tani ajo është një punëtore e lumtur me orar të plotë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë.

8 PUNË DINJETOZE
DHE RRIJJE
EKONOMIKE



Projekt/Shërbimet e ofruara nga IADK

IADK vazhdon të zgjerojë fushën e saj të punës duke ofruar ekspertizën dhe përvojat e saj për donatorë dhe partnerë të ndryshëm. Në këtë mënyrë, IADK krijon qëndrueshmëri dhe mund të bëhet një nga partnerët strategjikë më të vlefshëm për donatorët/partnerët. Gama e shërbimeve të ofruara përfshinë, por nuk kufizohet në, si vijon: hulumtime në sektorë të ndryshëm bujqësor, trajnime të fermerëve dhe asistencë teknike në terren për fermerët dhe konsulencë.



HULUMTIME

1. Për Danish Refugee Council, IADK ka kryer vlerësimin ekonomik të zinxhirit të vlerës në mëhallën e romëve, në jug të Mitrovicës, dhe ka gjeneruar një raport me gjetjet dhe rekomandimet për ndërhyrje.
2. Për Heinrich-Boll-Foundation, projekti i Hartimit të Modelit të Biznesit me Ndikim Pozitiv në Mjedis, IADK kreu një anketë me sektorët e bizneseve që nuk preokupohen tradicionalisht nga çështjet e lidhura me mjedisin dhe qëndrueshmërinë. Është përgatitur një raport me gjetjet dhe rekomandimet dhe është krijuar një platformë nga një grup rajonal për bashkëpunim.
3. Për SOWI Kosovo LLC, në kuadër të projektit të erës Bajgora, IADK analizoi nevojat e Personave të Prekur nga Projekti (PPP), më pas propozoi pako të ndryshme për përfshirje më të mirë të PPP-ve në aktivitetin social dhe ekonomik.
4. Për Food and Agriculture Organisation (FAO), IADK po bën një vlerësim mbi bujqësinë digjitale, gjininë dhe rininë në Kosovën rurale për gjithëpërfshirjen ekonomike. Rezultatet do të gjenerohen në vitin 2022.



TRAJNIME PROFESIONALE

1. Programi i Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (IWRM), financuar nga SDC, kontrakti IADK-në për të zgjedhur sektorin më premtues për ndërhyrje dhe për të trajnuar fermerët në praktikat më të mira bujqësore. Si rezultat, 58 fermerë posedojnë njohuri për uljen e presionit që vjen nga bujqësia si rezultat i keqpërdorimit të plehrave, pesticideve dhe ujit.
2. SOWI Kosovo LLC në kuadër të projektit të erës Bajgora kontrakti IADK për të mbështetur 40 PPP përmes programeve të zhvillimit të aftësive, zhvillimit të planeve të biznesit dhe paketës së granteve të vogla për të lartëpërmendurit.



KONSULENCA

Caritas i Zvicrës mandatoi IADK-në për të ofruar shërbime për projektin Zhvillimi Ekonomik Rural i Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës (SIRED). Shërbimet e ofruara në fushën e mbështetjes teknike, zhvillimin e sistemit të tregut, monitorimin dhe matjen e rezultateve, zhvillimin e kapaciteteve dhe këshillimin për bujqësinë organike dhe certifikimin, si dhe vlerësimin e aplikantëve për grant.



KËSHILLA TEKNIKE

PPSE – Promoting Private Sector Employment ka angazhuar IADK-në për të ofruar shërbime – ekspertizë për njërin nga përfituesit e PPSE nga Komuna e Graçanicës. Si shkak i shërbimeve teknike dhe praktike të ofruara nga IADK për 15 ditë, një fermer nga komuna e lartëcekur ka arritur të kultivojë si duhet 30 ari sipërfaqe me kalendulë, luledielli, mëllagë të zezë, mentë dhe hithër.

Partneritet Ndërkombëtar

Kontributi në zhvillimin e bujqësisë nuk është një detyrë e lehtë, prandaj IADK bashkëpunon me shumë partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të mbështetur sektorin dhe për të përmirësuar ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të palëve të ndryshme. IADK, që përfaqëson Kosovën, ka bërë marrëveshje me Senior Experten Service (SES) për të angazhuar ekspertë Gjermanë në pension për shërbime këshilluese për biznese, autoritetet publike, OJQ-të, shoqatat e bizneseve dhe institucionet e AAP-së në fushën e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit.

Këtë vit patëm fatin të presim tre (3) ekspertë Gjermanë në sektorin e përpunimit të qumështit, frutave dhe perimeve për tri (3) javë, të cilët kontribuan në ngritjen e kapaciteteve të departamentit të përpunimit të ushqimit.

Me qëllim të zhvillimit të shërbimeve këshillimore profesionale në përputhje me praktikat më të mira, IADK ka qenë anëtare e disa rrjeteve dhe shoqatave, qofshin ato ndërkombëtare apo kombëtare. Këto rrjete/shoqata përfshijnë:

1. European Forum for Agricultural and Rural Advisory Services (EUFRAS) është një rrjet evropian dhe shoqatë përfaqësuese e shërbimeve publike dhe private të zgjerimit rural dhe bujqësor e themeluar në vitin 2013. IADK është anëtare e EUFRAS që nga viti 2016.
2. South Eastern Europe Advisory Service Network - SEASN është rrjet i shërbimeve këshillimore bujqësore, odave bujqësore, instituteve bujqësore, fakulteteve dhe OJQ-ve i themeluar në Bullgari në vitin 2015. IADK është anëtare e bordit që nga viti 2015, dhe Drejtori Ekzekutiv i IADK, z. Zenel Bunjaku, mban pozitën e zëvendës drejtorit në këtë rrjet.
3. Në Kosovë, IADK është anëtare e Platformës CiviKos dhe Rrjetit të Grave të Kosovës.


**17 PARTNERITET
PËR OBJEKTIVAT**



Të ardhurat e IADK-së nga Projekt/Grantet



- Mbështetja e zinxhirit të vlerave të BMA përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimet të eksportit **149,786 Euro ose 19.85%**
- Përfshirja ekonomike e të rikthyerve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale **39,964 Euro ose 5.29%**
- Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës **52,236 Euro ose 33.42%**
- Mbështetja e ndërmarrësisë shoqërore dhe promovimi i fuqizimit social-ekonomik të komuniteteve moniritare në Kosovë **83,532 Euro ose 11.07%**
- Trajnime profesionale dhe mundësitë për gjenerimin e të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Kosovës **10,000 Euro ose 1.32%**
- Fuqizimi i të rinjve dhe grave nga zonat rurale përmes përfshirjes në bujqësi dhe përpunim të ushqimit **97,441 Euro ose 12.91%**
- Krijimi i punësimit në bujqësi **25,460 Euro ose 3.37%**
- Tranushumanca - ofertë e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi **34,908 Euro ose 4.62%**
- Mbështetja e punësimit të të rinjve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë **61,450 Euro ose 8.14%**




- Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
- Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
- Bread for the World (BftW)
- Danish Refugee Council (DRC)
- Organizata Feministe e Paqes-cfd
- Organizata Feministe e Paqes-cfd
- Zyra e Bashkimit European në Kosovë - Komunat (Pejë dhe Istog)
- Zyra e Bashkimit European në Kosovë - Komunat (Pejë dhe Istog)
- Zyra e Bashkimit European në Kosovë - Komuna (Shtime)



- Donatorët **556,362 Euro ose 73.71%**
- Komunat partnere **145,568 Euro ose 19.29%**
- Përfituesit **52,847 Euro ose 7%**

Shënim: Shuma e shpenzimeve për projekte është më e lartë se sa është paraqitur më sipër. Megjithatë, grafikët paraqesin shumën e pranuar nga donatorët, pjesa tjetër e shpenzimeve janë mbuluar nga parafinancimi i IADK-së.

Të ardhurat e IADK-së nga Projekt/Shërbimet



- Danish Refugee Council **13,000 Euro ose 10.80 %**
- EPI Centar **19,960 Euro ose 16.58%**
- Caritas Switzerland **25,500 Euro or 21.18%**
- Heinrich Boell Foundation (Zyra Rajonale për Evropën Juglindore) **8,085 Euro ose 6.72%**
- Swisscontact Kosovo (SC) **1,365 Euro ose 1.13%**
- SOWI KOSOVO **2,370 Euro ose 1.97%**
- Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë - FAO **8,528 Euro ose 7.08%**
- Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë - FAO **13,760 Euro ose 11.43%**
- Zyra e Bashkimit European në Kosovë (BE) **10,562 Euro ose 8.77%**
- Komunat Shtime, Vushtrria, Kamenica, Vitia dhe Skenderaj **17,250 Euro ose 14.33%**

#	Emri i Partnerit	Emri i Projektit	Shuma €	Përqindja %
1	Danish Refugee Council	Vlerësimi ekonomik i zinxhirit të vlerës në lagjën Rome, Mitrovicë e Jugut	13,000	10.80
2	EPI Centar	Mbështetje Teknike për Bujqësinë në Kosovë në kontekstin e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore	19,960	16.58
3	Caritas Switzerland	Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik rural	25,500	21.18
4	Heinrich Boell Foundation (Zyra Rajonale për Evropën Juglindore)	Hartimi I modeve të biznesit me ndikim pozitiv në ambientin e Kosovës	8,085	6.72
5	Swisscontact Kosovo (SC)	Shërbimet Këshillimore për Kultivimin e BMA	1,365	1.13
6	SOWI KOSOVO	Dizajnimi dhe zbatimi i programit të rivendosjes së mirëqenies	2,370	1.97
7	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë - FAO	Mbledhja e të dhënave për përcaktimin e bazës mbi ligjshmërinë e drurit dhe aspektin ekonomik të sektorit pyjor në Kosovë	8,528	7.08
8	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë - FAO	Vlerësimi i bujqësisë digjitale, gjinisë dhe rinisë në Kosovën rurale për gjithëpërfshirjen ekonomike	13,760	11.43
9	Zyra e Bashkimit European në Kosovë	Asistencë teknike për monitorimin e Skemës së Granteve për Mbështetjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural IPA 2015	10,562	8.77
10	Komunat Shtime, Vushtrria, Kamenica, Vitia dhe Skenderaj	Shërbimet këshillimore dhe trajnimet për fermerë	17,250	14.33
Total			120,380	100%

Shprehim mirënjohjen tonë për punonjësit, praktikantët dhe vullnetarët e vitit 2021



Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv



Basri Pulaj
Koordinator i Programit



Sylejman Bunjaku
Shef i Departamentit të Hortikulturës



Hafize Veseli
Shefe Departamentit të Përpunimit të Ushqimit & Menaxhere Projektit



Edita Mahmuti Mula
Menaxhere e Projektit



Egzon Gërxhaliu
Menaxher i Projektit



Fjolla Zuçaku
Menaxhere e financave



Arlindë Hyseni
Zyrtare Prokurimit & Menaxhere Financiare e Projektit



Elion Gërguri
Menaxher i Projektit



Jehona Drevinja
Zyrtare Prokurimit & Menaxhere Financiare e Projektit



Ariana Peci
Zyrtare Prokurimit dhe Administratës



Argjend Gjinovci
Zyrtar i projektit



Behare Mlinaku
Zyrtare e projektit



Besarta Hajrizi
Zyrtare Prokurimit dhe Administratës



Gonxhe Dobroshi
Zyrtare e projektit



Valentina Gerxhaliu Idrizi
Zyrtare Prokurimit dhe Administratës



Egzona Hajra
Inxhinier e Bujqësisë



Hasan Cena
Inxhinier i Përpunimit të Ushqimit



Halit Gashi
Inxhinier i Bujqësisë



Gëzim Murseli
Inxhinier i Bujqësisë



Leonora Hajra
Inxhinier e Blegtorisë



Novica Markovic
Inxhinieri i Bujqësisë



Hanumshahe Zeneli
Asistente për përgatitjen e ëmbëlsirave dhe asistente projekti



Elheme Shala
Asistente Financiare



Ema Kurshumlija
Asistente Projekti



Petrit Koci
IT



Nexhmedin Melenica
Inxhinier i ndërtimtarisë



Sadije Hasani
Mirëmbajtëse e objektit



Albin Aliu
Praktikant i projektit



Shqipe Musa
Praktikante e projektit



Fatbardha Hajzeri
Praktikane e projektit



Ardit Abazi
Praktikant i projektit



Fjolla Haziri
Praktikante e projektit



Donat Musiqi
Praktikant i projektit



Katrina Behramaj
Praktikante e projektit



Gylaj Hasani
Praktikante e projektit



Nora Ibrahim
Praktikante e projektit



Adisa Osmani
Praktikante e projektit



Katrina Krasniqi
Praktikante e projektit



Sarah Shaqiri
Vullnetare

Shënim: Gjithsej 53 praktikantë janë angazhuar në praktikë me ndihmën e IADK-së dhe 4 punëtorë të angazhuar nga IADK kanë kontribuar në dy komuna (Viti dhe Shtime).

Mirënjohje

Ne ju falënderojmë për mbështetjen tuaj të vazhdueshme në përpjekjet tona për të kontribuar në zhvillimin e bujqësisë në Kosovë.

Donatorët tanë:



Partnerët tanë:





Për më shumë
Më skanoni!



Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!

 Sfaraçak i Ulët, Rr. Miran Xhafa,
nr.11, 42,000 Vushtrri, Kosovë

 www.iadk.org

 info@iadk.org

 facebook.com/iadk.org

 iadk.org

 +383 49 777 046

+383 44 777 036